

**AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“SKYNET DATA SERVICE” SHPK**

**KREU I Dispozita të përgjithshme**

Sot, në datën 02/07/2021 personi i mëposhtëm:

**Z. GAZMEND KURTI**, atësia Muharrem , datelindja 18.11.1987 , lindur dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plete per te vepruar, mbajtes i letemjoftimit nr. Personal **I71118048S**;

ne cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plete e te sinquerie, dhe insiativën e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",

Vendosi te themeloje shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin  
**“SKYNET DATA SERVICE” SHPK**

**KREU II**

**Ortaket, Emri, Objekti, Kohzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1**

**Emri**

Shoqëria është organizuar dhe funksionon sipas formës Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe mban emrin **“SKYNET DATA SERVICE” SHPK**

**Neni 2**

**Objekti**

2.1 Shoqeria “SKYNET DATA SERVICE” SHPK do te ketë objekt veprimatarie:



Ofrues sherbimesh internet, perfshire por pa u kufizuar ne procesin e te dhenave per shoqerite dhe/ose entet publike, ndermjetesimit tregtar dhe biznesi, autorizuar per te ndihmuar gjetjen e klienteve dhe shperndarjen e produkteve dhe sherbimeve ne fushen e energjise, marketing ne fushat e telekomunikacionit dhe sherbimeve telefonike, trajnim te brendshem ose te jashtem te stafit dhe edukim profesional. Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te te treteve me seli ne Shqiperi apo ne cdo vend tjeter qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise duke respektuar ligjin ne fuqi. Shoqeria ka te drejte te bashkepunoje me persona juridike ose fizike ose me cilen do tjeter shoqeri me te njejtin objekt veprimtarie brenda ose jashte vendit. Objekt i ketij aktiviteti do te jete cdo lloj aktivitet i ngjashem i Iidhur si me siper qe do te konsiderohet i vlefshem nga vete politikat tregtare te shoqerise dhe qe nuk bien 8 ndesh legjislacionin ne fuqi qe udheheq fushen e marredhenieve te tregtise se lire ne territorin e Republikes se Shqiperise. Sherbime ne lidhje me "Marketing Online", IT, zhvillime software, telemarketing, zhvillime strategjish marketing, aplikacion Web, reklamim fizik dhe online, etj.

#### **Neni 3**

##### **Kohëzgjatja**

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.

#### **Neni 4**

##### **Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën : Tirane, Njësia Administrative Nr 8, Rruga "Ferit Xhajko" , Ndertesa nr 128, Hyrja I, Kati II .

##### **Kreu III**

##### **Vlera dhe pagesa e kapitalit**



## **Neni 5**

### **Kapitali**

**5.1 Kapitali I rregjistruar I shoqërise është 300.000 Lek ( treqind mijë lek), I barabartë me 1 kuotë. Kontributet e ortakëve perbejne kapitalin e shoqërisë.**

**5.2 Pjesmarja e Ortakut në kapitalin e Shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotës së cdo ortaku llogaritet në raport me secilin kontribut paraqitur si më poshtë:**

**Gazmend Kurti zoteron 100% të kapitalit = 1 kuotë = 300.000 lek.**

Kontributi mund te jetë në para ose në natyrë.

**5.3 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakut të vtëm të shoqërisë.**

## **Neni 6**

### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi I Kapitalit Themeltar**

**6.1 Asambleja e Pergjithshme , me shumicë të kualifikuar , mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e krtakëve egzistues në shumën e pëecaktuar në vendimin përkatës.**

**6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së pëergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave sipas nenit 87 të ligjit.**

## **Neni 7**

### **Transferimi I kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar
- b) shitblerjes
- c) trashëgëmisë
- d) dhurimit
- e) cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, pës sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rruge trashigimie.

## Kreu IV

### **Asambleja Përgjithshme**

#### **Neni 8**

##### **Kompetencat dhe Thirrrja e Asamblesë së Përgjithme**

**8.1** Asambleja përgjithshme është organi më i lartë i vendimarrjes së shoqërisë .

Asambleja e përgjithshme do të vendlodë por pa u kufizuar për cështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) percaktimi I politikave tregtare
- b) ndryshimet e Statutit
- c) emerimi dhe shkarkimi administratoit
- d) emërimi I ekspetëve kontabel
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi securinë e aktiviteti
- f) zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit
- g) pjesëtimi I këotave dhe anulimi I tyre
- h) cështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare

**8.2** Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme thirret nga administrator apo ortakët sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare nëpërmjet një njoftmi me letër rekomande ose me postë elektornike (email).

Njoftmi duhet të kryhet të pakten 7 (shtatë) dit të plota përpëra datës së caktuar për mbledhjen e saj.

#### **Neni 9**

### **Kuorumi i nevojshëm**

Asambleja e përgjithshme mund te mare vendime te vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm qoftë edhe nepërmjet personave të autorizuar, ortakët me të drejtë vote që



përfaqësojn no më pak se 51% të kapitalit të shoqërisë.

## Neni 10

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithme mund të marrë vendime me anën e votës pro të shumicës së ortakeve që janë pjesmarrës ne mbledhje mbi cështjet e mëposhtëmë por pa u kufizuar vetëm në to.

- a) percaktimi I politikave tregtare
- b) ndryshimet e Statutit
- c) emerimi dhe shkarkimi administratoit
- d) emërimi I ekspetëve kontabel
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktiviteti
- f) zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit
- g) pjesëtimi I këotave dhe anulimi I tyre
- h) cështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare

## Neni 11

### Votat e ortakëve

Cdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

## Neni 12

### Emërimi I Administratorit

12.1 Asambleja e Pergjith shme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për një periudhë pesëvjecare në pajtim me parashikimet e shkronjës c të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të ligjit .

12.2 Personi I mëposhtëm caktohet si Administrator I **shoqërisë “SKYNET DATA SERVICE” SHPK:**

, **Z. GAZMEND KURTI**, atësia MUHARREM , Datelindja 18.11.1987

, lindur dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Letemjsoftimit nr. Personal **I71118048S** për një afat 5 vjecar , nga moment I rregjistrimit pranë QKB.



## **Neni 13**

### **Kompetencat e administratorit**

Administratori do ketë kompetencat e mëposhtëme por pa u kufizuar .

- a) do të drejtojë dhe përfaqësojë shoqerinë përsa I përket administrimit të zakonshëm.
- b) do të nënshkruaj cdo marrveshje në emër të shoqërisë
- c) do të hapë llogari bankare në emër të shoqërisë
- d) do të urdhërojë dhe kryejë pagesa në emër të shoqërisë
- e) do të kujdesët për mbajtjen e sakteë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël
- f) do të krijojë një system monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm përrrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë
- g) do ti raportojë Asambles së përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të vecantë.
- h) do të punësojë , emërojë e shkarkojë të punësuar të cdo niveli

## **Neni 14**

### **Skualifikimi dhe shkarkimi I administratorit**

Detyra e administratorit përfundon në rast se:

perësoni nuk është me administrator sipas parashikimeve te ligjit perfshirë parashikimet e pikës 6 nenit 95 të ligjit.

personi vuan ose mund të vuajë nga rrëgullime mendore

ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e paaftësisë fizike

jep dorëhejen nga detyra duke njoftuar shoqerinë

vdekjeje

ndodhet në situate apo rrethana që e bëjnë të pamundur ushtrimine detyrave



## **Neni 15**

### **Kufizimet në veprimet e Administratorit**

Administratori nuk do lejohët të lidhë marrveshje për cështje në të cilat ai ka konflikt interes i . Gjithashtu ai nuk mund të lidhi marrëveshje në kundërshtim me interest e shoqërisë , në pajtim me nenin 13 të ligjit për shoqëritë tregëtare.

### **Kreu V**

### **Prishja dhe njoftimet**

## **Neni 16**

### **Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria prishet kur:

- a) kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për mbulimine shpenzimeve të falimentimit
- c) në raste të tjera të parashikuara në statut
- d) në raste të tjera të parashikuara në ligj
- e) për vdo shak tjetër të vendosur nga asambleja përgjithme
- f) administratori është i detyruar të njoftojë prishjen e shoqërisë ne QKB përvèc prishjes me vendim gjykate

## **Neni 17**

### **Njoftimet**

**17.1** Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë meshkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e emailit.

**17.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke dërkuar letër rekomande në adresën e ortakëve ose në postën elektonike të tyre.

## **Neni 18**

### **Viti finanziar**

**18.1** Viti finanziar zgjat 12 muaj dhe fillon ne daten 1 Janar dhe mbaron në daten 31 Dhjetor.

Në fund të cdo viti finanziar administratori harton bilacin finanziar dhe raportin e administrimit, më pas këro raporte cohen për miratim ne mbledhjen e asmablesë.



## Neni 19

### Dizopozita përfundimtare

**19.1** Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqërse që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimitarise se shoqerisë. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesensht ose teresisht dhe te, zqvendesohet me një statut te ri vetem me:..vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar të percaktuar më siper.

**19.2** Per sa nuk është parashikuar në kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

**19.3** Ky statut u hartua ne 4 kopje me përbajte dhe vlerë juridike të njejtë, në gjuhën Shqipe si dhe u nënshkrua nga palët pa asnje rezervë

### Ortaku Themelues

Gazmend Kurifi  
